



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 2112 prot.

Tiranë, më 04/05/2020

URDHËR

Nr. 292, datë 04.05.2020

“PËR MËNYRËN E VETËKARANTINIMIT TË PERSONAVE QË
RIATDHESOHEN“

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 1 gërma c, të Ligjit nr.15/201, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

1. Të gjithë shtetasit shqiptar që riatdhesohen në Republikën e Shqipërisë gjatë periudhës së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 dhe janë me banim në një nga “zonat e kuqe” mund të vetëkarantinohen në ambjentet e shtëpisë për një periudhë 14 ditore.
2. Të gjithë shtetasit shqiptar që riatdhesohen në Republikën e Shqipërisë gjatë periudhës së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 dhe janë me banim në një nga “zonat e gjelbërta” do të karantinohen për një periudhë 14 ditore në ambjentet e një strukture akomoduese sipas përcaktimeve të bëra me Vendimin nr. 311, datë 16.04.2020 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e organizimit të akomodimit të përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga covid-19”, i ndryshuar.
3. Mosrespektimi i detyrimit të përcaktuar në këtë urdhër për vetëkarantinim për 14 ditë të personave që riatdhesohen është i dënueshëm sipas legjislacionit në fuqi.
4. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor mbikëqyr zbatimin e Urdhrit dhe vendos masën e gjobës, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

